



RAPORT MBI DISKUTIMIN PUBLIK TË REALIZUAR lidhur me **Propozimin e Vendimit mbi ndryshimet dhe plotësimet e Vendimit mbi** **Buxhetin e komunës së Tuzi për vitin 2024**

Sipas konkludimit nr. 01-400/24-5667/1 prej më 13.08.2024 kryetari i komunës së Tuzit, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Vendimit për pjesëmarrjen e popullsisë lokale me kryerjen e çështjeve publike, ka përcaktuar Propozimin e Vendimit mbi ndryshimet dhe plotësimet e Vendimit mbi Buxhetin e komunës së Tuzit për vitin 2024. Me Programin e diskutimit publik, i cili është i publikuar në faqen e internetit www.tuzi.org.me dhe u është dorëzuar këshilltarëve të Kuvendit të Komunës së Tuzit si dhe kryetarëve të bashkësive lokale. Projektvendimi mbi ndryshimet dhe plotësimet e Vendimit mbi buxhetin e Komunës së Tuzit për vitin 2024 është vënë në diskutim publik për 15 ditë, duke filluar nga data 22 gusht 2024, e me përfundim më 05.09.2024.

Sipas programit të përcaktuar, në ambientet e Kuvendit të Komunës së Tuzit më 05.09.2023 është mbajtur diskutimi qendror publik duke filluar nga ora 10:00.

Diskutimin publik në formë elektronike, me shkrim dhe me gojë e ka zhvilluar Komuna e Tuzit.

Gjatë diskutimit publik, qytetarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë iu dha mundësia të shprehin mendimet e tyre me shkrim, në mënyrë elektronike dhe me gojë.

Përfaqësues i propozuesit ishte z. Driton Gjokaj, sekretar i Sekretariatit për Financa, i cili bëri një prezantim hyrës mbi propozimin e vendimit përkatës.

U sqarua se Propozimi i vendimit për ndryshimet dhe plotësimet e Vendimit mbi Buxhetin e Komunës së Tuzit për vitin 2024 ë përgatitur në bazë të nenit 8 të Ligjit për Buxhetin dhe Përgjegjësinë Fiskale ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 20/14, 56/14, 70/17, 04/18 dhe 55/18, 66/19 dhe 70/21, 027/23, 125/23), neni 31 i Ligjit për financimin e vetëqeverisjes lokale (Fleta Zyrtare e Malit të Zi 03/19, 086/22, 005/24, 007/24), Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (" Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr.02/18, 34/19, 38/20 dhe 84/22), të Statutit të Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi" – dispozitat komunale nr. 24/19, 05/20, 51. /22, 55/22).

I Propozimi i Vendimit mbi ndryshimet dhe plotësimet e Vendimit mbi Buxhetin e **Komunës së Tuzit për vitin 2024**

Diskutimet e pjesëmarrësve në diskutimin publik:

Z. Driton Gjokaj, sekretar i Sekretariatit për Financa, i njoftoi të pranishmit me Propozimin e Vendimin për ndryshimet dhe plotësimet e Vendimit mbi Buxhetin e Komunës së Tuzit për vitin 2024, si dhe prezantoi përmbajtjen e vendimit. Ai ftoi të pranishmit të pyesin gjithçka që u intereson, duke theksuar mundësinë e dorëzimit të sugjerimeve dhe vërejtjeve në arkivin e



Mali i Zi / Crna Gora
Komuna e Tuzit / Opština Tuzi
Sekretariati për financa
Sekretarijat za finansije
Nr./Br. 05-400/24-5667/5

Rruga Tuzi nr. 1 , nr. 44
Ulica Tuzi br.1 , br. 44
+382 20 875 152
finansije@tuzi.org.me
Tuz – Tuzi, 11.09.2024. godine

Komunës si dhe me email. Gjatë seancës qendrore të diskutimit publik nuk pati asnjë sugjerim apo vërejtje nga pjesëmarrësit.

Për Projektvendimin në fjalë, subjektet në vijim kanë dorëzuar komente, sugjerime dhe mendime me shkrim dhe me e-mail brenda afatit të caktuar (në lidhje me pjesën rrjedhëse të buxheti dhe atë kapitale):

Subjekti	Vërejtje/sugjerim/koment	Pranohet/Refuzohet
QKI “Malësia”	Rritje e transfertave për subjektin e dhënë në vlerën 13 000,00 euro	Është pranuar. Zëri 4326 - Transfertat drejt shoqërive dhe institucioneve publike shtohen me shumën e kërkuar të fondeve.
OJQ “Zhvillimi i Vranes”	Rritje në zërin 4414 – Shpenzime për blerje toke prej 40 000,00 euro për shkak të blerjes së tokës në fshatin Vrane për ndërtimin e këndit të lojërave.	Refuzohet. Komuna aktualisht nuk është në gjendje të financojë blerjen e tokës.
Edmond Ujkaj, Rakiq	Rindërtimi i rrugës për në Rakiq.	Refuzohet. Komuna në përputhje me mundësitë e saj ka bërë riparimin e rrugës. Në periudhën e ardhshme do të ketë më shumë diskutime për planifikimin e investimeve kapitale
Sekretariati për Urbanizëm i Komunës së Tuzit	- Hartimi dhe rishikimi i dokumentacionit teknik për nevojat e rindërtimit të rrugëve lokale, - Hartimi dhe rishikimi i dokumentacionit teknik për ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në komunën e Tuzit - Hartimi dhe rishikimi i dokumentacionit teknik për ndërtimin e një ure në lumin Cem në Dinoshë.	Është pranuar. Ndryshime u miratuan në pjesën kapitale të buxhetit dhe zërin 4412 - Shpenzime për infrastrukturën lokale.

Sekretari
Driton Gjokaj

